



05.03.2010

Shqyrtimi i Katërt i Tarifave të Energjisë Elektrike 2010 (SHTE 4)

Komentet e KOSTT ndaj Raportit Konsultativ

Prishtinë

Vërejtjet Fillestare

KOSTT Ju falënderon për dy dokumentet e pranuar:

- Raporti Konsultativ i datës 26 Shkurt 2010 që paraqet këndvështrimet e juaja në propozimin e KOSTT-it për të hyrat e lejuara për t'u përmirësuar nga tarifat e rregulluara; dhe
- Raporti Konsultativ - Korrigjimet dhe përshtatjet në aplikacionin e KOSTT, i datës 25 Shkurt 2010 i cili ofron një përmbledhje të intervenimeve, korrigjimeve dhe përshtatjeve nga ZRrE-ja në aplikacionin e KOSTT-it.

Në vazhdim KOSTT çmon mundësinë e ofruar për t'u takuar dhe mbajtur diskutime për të sqaruar parimin bazë të kalkulimit e cila përforcon përgjigjen tuaj.

Ky dokument është përgjigja finale e KOSTT brenda periudhave kohore të publikuara të shqyrtimit tuaj dhe kërkon për të siguruar sqarim të mëtejme mbi një numër të temave të veçanta të ngritura gjatë Shqyrtimit të Katërt të Tarifave të Energjisë Elektrike 2010, edhe pse ne do të vazhdojmë me disa sqarime në disa çështje të cekura në raportin tuaj.

Shpenzimet Shtesë

Raporti Konsultativ i ZRrE-së i datës 26 Shkurt 2010 i referohet paragrafit 3.3.8 në vlerë prej €0.1m brenda aplikacionit të KOSTT-it për pagesën lidhur me performansën. Propozimi i ZRrE-së është që të zvogëlohen të hyrat e lejuara të KOSTT për këtë element.

KOSTT beson fuqishëm se është i rëndësishëm stimulimi dhe motivimi i stafit me qëllim të arritjes së përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e transmissioinit brenda Kosovës. KOSTT është i mendimit se arritjet në vitin 2009 në përballimin e nivelit rekord të kërkesës prej 1,170MW pa reduktim të ngarkesës, duke vazhduar në zvogëlimin e humbjeve të transmissioinit në 174.5GWh dhe zvogëlimin e kërkesës së pa dërguar, ka qenë e mundur vetëm përmes nivelit të lartë të aftësive dhe angazhimeve të stafit.

Duke marrë parasysh se gjendemi para procesit të privatizimit të KEK-ut, situata që pritet të krijohet është humbja e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të cilat KOSTT ka bërë investime të larta që nga themelimi, duke bërë përgatitjen profesionale dhe trajnimin adekuat të tyre. Hapja e tregjeve të reja të punës, si kompanitë private që do të formohen nga privatizimi paraqesin një rrezik serioz për KOSTT.

Me qëllim të rekrutimit dhe mbajtjes së stafit me kualifikime të larta të nevojshëm për të vazhduar këtë nivel të përmirësimit, kompania duhet të jetë e aftë për të ofruar paketa të mjaftueshme atraktive të shpërblimeve. Ekziston një kërcënim real se nëse dështon ta bëjë atë, KOSTT do të ballafaqohet me humbje të konsiderueshme të përvojës dhe aftësisë dhe pasojave të pashmangshme të kostove shtesë të zëvendësimeve në rekrutim dhe trajnim.

Mirëmbajtja

KOSTT është i zhgënjyer me propozimin e ZRrE-së në Raportin Konsultativ paragrafi 3.3.7 në ndryshimin e trajtimin të kapitalizimit të tepriçës së financimit të mirëmbajtjes. Kapitalizimi i mirëmbajtjes ka qenë qartë një mekanizëm në vitet paraprake për të lejuar KOSTT-in të financoj shpenzimet kapitale dhe KOSTT ka qenë transparent në shfrytëzimin e tij të fondeve të mirëmbajtjes në këtë mënyrë. Përndryshe, niveli i investimeve kapitale do të ishte vështirë të arrihet përmes metodologjisë së tarifave me vlerë zero të caktuar për asetet para-2006. KOSTT vëren se

ZRrE-ja ka shprehur dëshirën për të diskutuar më tej vlerësimin e këtyre aseteve edhe pse duke cekur se për shkak të zhvillimeve tjera në sektorin e energjisë, procesi i vendosjes së tanishme të tarifës nuk është konsideruar si një kohë e përshtatshme për ta adresuar këtë. Megjithatë, pavarësisht zhvillimeve tjera, KOSTT beson se ndryshimet në mekanizmin e kapitazimit të mirëmbajtjes do ta bën të nevojshme konsiderimin e më hershëm të vlerësimeve të aseteve të para-2006, dhe pret me pa durim avancimin e këtyre diskutimeve më vonë këtë vit.

Largimi i aseteve të cilat kanë qenë të financuara në këtë mënyrë nga RAB si dhe nga RABf është rregullim retrospektiv dhe vetëm mund të rrisë pasigurinë e Rregullatorit në një kohë kur Kosova kërkon inkurajimin e investimeve të jashtme.

Derisa kërkohet një zgjidhje afatgjate përmes rivlerësimit të aseteve para-2006, KOSTT propozon se një kompromis i arsyeshëm do të ishte largimi i aseteve nga RABf por duke i mbajtur ato në RAB, trajtim ky i njëjtë me asetet e financuara nga donatorët.

Humbjet

KOSTT ka shqyrtuar kalkulimet e humbjeve të veta dhe është në një pozitë për të pranuar kalkulimet ashtu sikur janë paraqitur nga ZRrE në paragrafin 3.2.2 të Raportit Konsultativ dhe Raportit Konsultativ të datës 25 Shkurt 2010, duke demonstruar humbjet e realizuara prej 174.6 GWh për vitin 2009.

KOSTT do të provoj të mbajë nivelin e njëjtë të ulët të humbjeve në vitin 2010 pavarësisht shkyçjeve të pashmangshme të cilat do të nevojiten për të implementuar nivelin e lartë të shpenzimeve kapitale ashtu si janë të paraqitura në Planin e Investimeve dhe ndikimet negative të shkyçjeve të tilla në nivelin e humbjeve.

Vërejtjet Përfundimtare

KOSTT dëshiron të theksojë se bazuar në të hyrat e lejuara totale të propozuara në tabelën 3 të Raportit Konsultativ të ZRrE-së, raporti i tarifës së transmisionit ndaj tarifës së përgjithshme është më pak se 6% duke llogaritur subvencionet e përgjithshme që KEK i pranon. Shifrat e fundit të Komunitetit të Energjisë të publikuara në Mars 2009¹ tregojnë se kjo vlerë është afër kufirit të ulët të anëtarëve të Komunitetit të Energjisë. Raporti i njëjtë paraqet se Kosova gjithashtu ka koston më të ulët të transmisionit për njësi të energjisë së transmetuar, në Komunitetin e Energjisë.

ZRrE nuk ka propozuar rritje të tarifave për vitin 2010. Pasi që KOSTT tashmë ka çmime shumë të ulëta të shërbimeve të transmisionit, kjo mund ta godas në mënyrë të pafavorshme aftësinë e KOSTT për të kërkuar financime aq shumë të nevojshme përmes huamarrjeve komerciale.

Me gjithë pikat e veçanta të ngritura lartë të cilat janë ende në diskutim, KOSTT është i gatshëm të pranoj propozimin e ZRrE të paraqitur në Raportin Konsultativ të datës 26 Shkurt dhe do të vazhdoj të operoj Sistemin e Transmisionit me të hyrat e lejuara.

KOSTT dëshiron të falënderoj ZRrE-në për dialog të hapur dhe konstruktiv përgjatë procesit të shqyrtimit, dhe i ofron mundësinë për të siguruar çdo informatë shtesë që mund të nevojitet.

(fund i dokumentit)

¹ www.energy-community.org/pls/portal/docs/284177.pdf